

## 4.4 AUTONIVELANT EPOKSID

### EPOFLOOR FG-8700



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
5 kg/kovë 15 kg/kovë	36 cp/paletë 12 cp/kuti	1.5kg/m <sup>2</sup> /mm -	Gri/transparent



#### EPOFLOOR FG - 8700

Vetënivelues me bazë epokside, 2 komponentësh.

#### PËRSHKRIMI

EPOFLOOR FG - 8700 është një produkt nivelizues me bazë çimento dhe rezinash epokside, si dhe nuk përmban solvent. Ofron avantazhet e mëposhtme:

- Rezistenca të larta mekanike.
- Lidhje shumë e mirë me sipërfaqen ku aplikohet.
- Rezistencë e lartë ndaj lagështirës.
- Ka aftësi shumë të mira nivelizuese.
- Nuk ka efekt korrodues.
- Klasifikohet si CT - C50 - F10 - AR0,5 sipas EN 13813.

#### FUSHAT E APLIKIMIT

EPOFLOOR FG - 8700 përdoret për riparime dhe nivelizimin e sipërfaqeve që do përdoren për: shtresë poliuretani, dysheme PVC, laminat, parket druri etj. EPOFLOOR FG - 8700 aplikohet kur betoni është relativisht i freskët, për të krijuar sipërfaqen e duhur (me të paktën 2 mm trashësi) për aplikimin e shtresave epokside, për të shmangur problemet me shkëputjen, etj. Gjithashtu, është e përshtatshme si shtresë përfundimtare, në një trashësi deri në 3 mm, për sipërfaqe të lëmuara, nivelimim dhe për të rritur rezistencën e sipërfaqes ndaj ngarkesave mekanike.

#### UDHËZIME PËR PËRDORIM

##### 1. Sipërfaqja

Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë:

- E qëndrueshme dhe e thatë ose me pak lagështi, pa praninë e ujit.
- E pastër, pa materiale që parandalojnë lidhjen, të tilla si pluhur, grimca të lirshme, yndyrna, etj. Për sipërfaqe shumë absorbuese ose poroze, sipërfaqja duhet të trajtohet me astarin epoksid me bazë uji EPOXY PRIMER W - 4000, siç është ose i holluar me 10% ujë. Astarti aplikohet me furçë ose rrul në një shtresë.

Aplikimi i EPOFLOOR FG - 8700 vijon pasi astari mund të shkelet.

#### PËRZIERJA

Komponentët A dhe B janë paketuar në proporcione të paracaktuara përzierjeje. Fillimisht, komponenti A duhet të përzieret mirë në enën e tij dhe më pas duhet të zhvendoset në një enë të pastër prej përafërsisht 30 litra vëllim. Më pas e gjithë sasia e komponentit B duhet të shtohet në komponentin A. Është e rëndësishme që të bëhet një përzierje e mirë pranë anëve dhe në fund të kovës, për të arritur shpërndarje uniforme të forcuesit. Nuk duhet të shtohet ujë në përzierje.

#### MËNYRA E APLIKIMIT

EPOFLOOR FG - 8700 duhet të aplikohen në një trashësi deri në 3 mm duke përdorur një mallë me dhëmbëza. Në mënyrë që të largohet ajri brenda shtresës vetëniveluese, sipërfaqja duhet të kalohet me një rrul të veçantë me gjemba. Kjo parandalon formimin e fluskave dhe ndihmon për të arritur një trashësi uniforme.

#### PASTRIMI I MJETEVE:

Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i fortuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

#### PAKETIMI

EPOFLOOR FG - 8700 është i disponueshëm në paketim 5kg dhe 15kg

#### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketim original dhe të pahapur i pa ekspozuar ndaj rrezeve të diellit dhe ngricës.



#### TË DHËNA TEKNIKE

Baza kimike (A+B)	Rezinë epokside 2 komponentëshe
Densiteti A	1,96 Kg/l
Densiteti B	1,05 Kg/l
Jetëgjatësia	afërsisht 30 min në +20°C
Temperatura minimale për forcim	+8°C
Koeficienti i difuzionit të lagështisë	Sd = 0,75 (EN ISO 7783 - 1/2)
Kalueshmëria	pas 15 orësh at +23°C
Rezistencat finale	pas 28 ditësh at +23°C
Rezistenca në shtypje	70 N/mm <sup>2</sup> (EN 13892 - 2)
Rezistenca në perkulje	20 N/mm <sup>2</sup> (EN 13892 - 2)
Forca ngjitëse	>4 N/mm <sup>2</sup>
Trashësia maksimale	3 mm

#### VËREJTJE!

- Koha e punueshmërisë së produktit ulet kur temperatura rritet.
- Sipërfaqja e EPOFLOOR FG - 8700 pas aplikimit duhet të mbrohet nga lagështia për 24 orë. Lagështia mund të zbardhë sipërfaqen ose ta bëjë atë ngjitëse. Lagështia gjithashtu mund të dëmtojë forcimin.
- Shtresat e dëmtuara në pjesët e sipërfaqes duhet të hiqen duke i gërryer dhe aplikohet përsëri produkti.
- Në rast se koha është më e gjatë se ajo e parashikuar ndërmjet aplikimit të shtresave të njëpasnjëshme ose në rast se shtresat e vjetra do të shtrohen përsëri, atëherë sipërfaqja duhet të pastrohet mirë para aplikimit të shtresës së re.
- Pas ngurtësimit, EPOFLOOR FG 8700 është totalisht i padëmshëm.
- Para përdorimit, konsultohuni me të dhënat që ndodhen në etiketën e produktit.